



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË**

VENDIM

Nr 86 datë 04.11.2022

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIM NR 38, DATË 31.05.2022

**“ PËR MIRATIMIN E PËRFUNDIMIT TË PROCEDURAVE TË PRIVATIZIMIT
TË BANESAVE, TË CILAT KANË MBETUR PA U REGJISTRUAR NË ZYRËN E
REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME (SOT ASHK) PËR LIDHJEN
E KONTRATAVE PARA NOTERIT”**

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 2, 23 e vijues, në ligjin nr.9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, i ndyshuar, neni 35, në ligjin nr.9321, datë 25.11.2004 “Për privatizimin e banesave dhe objekteve, të kthyera në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore”, Vendimin Nr.898, datë 18.11.2020 “ Për rregullat , kushtet, kriteret e procedurat e privatizimit të banesave dhe të objekteve të kthyera në fond banese të paprivatizuara”, dhe dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.97, datë 03.02.2008 “Për procedurat e privatizimit të banesave, objekt i ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, pika 3 e vijues, Këshilli i Bashkisë Gjirokastrë, në mbledhjen e datës 04/11/2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë procedurën e perfunduar të privatizimit të apartamenteve, përkatësisht lidhja e kontratave të shitblerjes para noterit, banesat e të cilëve kanë mbetur pa u regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gjirokastrë, për qytetarët si më poshtë:

| Nr. | ADRESA | EMRI MBIEMRI |
|-----|---|--------------------|
| 1 | Lagjja “Blloku i Furrave, ish konvikti i punëtorëve të N N” | Emin Habipi |



2. Të miratojë vlerën e pagesës prej 73.853 lekë , e cila do të paguhet nga përfituesi i banesës.

3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë së Gjirokastrës ose personi i autorizuar prej tij për lidhjen e kontratës së privatizimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT



